

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit B. E., Sh.a, me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A. H. jurist nga Prishtina, kundër të paditurve “3.” Sh.p.k. me seli në Gj., rruga “...” nr., B. G., nga Gj., F. G., dhe “V.” Company sh.p.k., me seli në Gj., që të tre me adresë rruga “...” nr. me objekt kontesti kthimin e borxhit, në shumë të përgjithshme prej 416,388.52 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 10.05.2017, në prani të autorizuarit të paditëses si dhe në mungesë të të paditurve, ndërsa me datën 22.05.2017 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B. E.
II. , Sh.a, me seli në Prishtinë.

II. DETYROHEN në mënyrë solidare që të paditurit “3.” Sh.p.k. me seli në Gj., B. G. nga Gj., F. G. nga Gj. dhe “V.” C. Sh.p.k. me seli në Gj., që në emër të borxhit t’ia paguajnë paditëses shumën e përgjithshme prej 416,388.52 euro (katërqind e gjashtë mbëdhjetë mijë e tre qind e tetë dhjetë e tetë euro e pesë dhjetë e dy cent) me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 20.11.2015 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin partitiv prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

III. DETYROHEN në mënyrë solidare të paditurit që paditëses t’ia kompensoj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej: 500.00 euro, në afatin kohor prej 7 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësija B. E., Sh.a, me seli në P., ka parashtruar me datë 20.11.2015, padi ndaj të paditurëve “3.” Sh.p.k. me seli në Gj., B. G. nga Gj., F. G. dhe “V.” C. sh.p.k. me seli në Gj., duke kërkuar që të paditurit t’ia paguajnë borxhin në emër shumës së papaguar për kredi me normën e interesit të rregullt 13% si dhe kamatë vonesën 1% mujore, duke filluar nga data 27.10.2015 e deri në pagesën definitive, njëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore vetëm sa i për ketë taksës për padi.

Lidhur me këtë çështje juridike gjykata duke u bazuar në nenin 423 paragrafi 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës mbajti seancën kryesore, në mungesë të të paditurve me propozimin e paditësit, pasi që të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt dhe atë për të paditurin e parë “3.” Sh.p.k. i autorizauri i tij F. G. ka qenë i ftuar përmes procesverbalit të datës 24.04.2017, kurse për të paditurit B. G., Fa. G. dhe “V.” Company me seli në Gj., janë ftuar në

menyrë të rregullt, me çka u vërtetua nga fletëkthesat të cilat gjindet në shkresat e lëndës, por mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar.

I autorizuari i paditësit gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se të paditurit i kanë dhënë dy kredi dhe atë 233,000.00 euro, sipas kushteve të precizuara në marrëveshjen kreditore për kredi për biznes nr.1385/2/Gja të datës 30.09.2010, marrëveshja hipotekare mbi pasurinë e paluajtshme nr.1385/3/Gja, të datës 30.09.2010 dhe marrëveshja mbi pengun nr.1385/4/Gja të datës 30.09.2010, dhe kredia e dytë në shumën prej 200,000.00 euro, sipas kushteve të precizuara me marrëveshjen kreditore për kredi për biznes nr.64071/1/Gja, të datës 19.04.2012, marrëveshja hipotekare mbi pasurinë e paluajtshme nr.64071/3/Gja, të datës 19.04.2012, dhe marrëveshja mbi pengun nr.64071/2/Gja të datës 19.04.2012, dhe se këto marrëveshje janë siguruar me sendet e paluajtshme me shënime si në marrëveshjen mbi pengun, mirëpo të paditurit (debitorët) në cilësinë e bashkë-huamarrësve dhe penglënësve të produkteve kreditore të lartpërmendura nuk i janë përmbajtur obligimeve të cilat i kanë marrë me marrëveshjet e lartë përmendura kështu që të paditurit nuk i kanë kryer obligimet. Andaj banka ka qenë e detyruar që të fillon procedurën e rregullt gjyqësor me qëllim të kthimit të borxhit në lidhje me të cilën është inicuar procedura përmbarimore me aktvendim të Gjykatës Komonale në Gjakovë E.nr.1339/13 të datës 27.01.2015, mirëpo paditësja nuk ka mundur ta përmbushë borxhin në procedurë përmbarimore për shkak se kolaterali i lënë peng është tjetërsuar. Andaj paditësi me parashtrësën e datës 29.03.2017, ka bërë precizimin e kërkesë padisë ndaj të paditurve ashtu që i detyrohen paditësës për borxhin e për bashkët me kamatë shumën prej 449,091.22 euro ka theksuar i autorizuari i paditës.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri i parë "3." Sh.p.k. me seli në Gj. përmes përgjigjes në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të parregullt, po ashtu ka theksuar se është e vërtetë që i padituri i parë ka marrë kredi por shuma e marrur dhe ajo e kërkuar dukshëm dallojnë njëra prej tjetrës, andaj i ka propozuar gjykatës që e njëjta të refuzohet si e pabazuar. Po ashtu të paditurit B. G., Fatmir G. dhe VF Company Sh.p.k. përmes përgjigjes së përbashkët në padi e kanë kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa rregullt, tendencioze dhe qellim keq. Duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta hudhë poshtë si të pathemeltë.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i kanë kërkuar.

Gjykata ka administruar provat e propozuara nga palët në procedurë dhe atë: marrëveshja kreditore për kredi për biznes me nr.1385/2, e datës 02.09.2010, marrëveshja për kredi me nr.64071/1 e dt. 19.04.2012, marrëveshja hipotekare nr.1385/3 datës 30.09.2010, marrëveshja hipotekare nr.64071/3 e datës 19.04.2011, marrëveshja mbi pengun me nr.1385/4 e datës 30.09.2010, marrëveshja mbi pengun me nr.64071/2 e Datës 19.04.2012, pasqyra e obligimeve të arritura e datës 30.09.2010, 24.04.2012, certifikata e biznesit e paditurit të parë 3. Sh.p.k. me nr.70165956, propozimi për përmbarim i datës 11.09.2013, 15.11.2013, procesverbal i datës 11.09.2015 nga përmbaruesi privat, procesverbal me numër 211/14 pa datë, dy konkluzione i datës 12.09.2015, dy urdhra nga përmbaruesi privat të datës 26.10.2015, procesverbal mbi regjistrimin dhe evidentimin e sendeve i datës 27.10.2015, pasqyra e obligimeve të arritura nga

paditësi e datës 28.03.2017 (dy faqe), politikat për trajtimin e kamatat e rregullta dhe kamatëvonesa (rregullore e paditësit).

Provat e propozuara dhe të administruara, deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse gjykata i vlerësoi, të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

Në mes palëve në procedurë nuk ishte kontestuese marrëdhënja afariste e as borxhi ashtu siç e pohojnë edhe vet të paditurit, por kontestuese ishte sa ka mbetur e paditura borxh paditësit gjegjësisht lartësinë e borxhit.

Në bazë të provave të administruara gjykata ka vërtetuar faktin se palët në procedurë kanë qenë në marrëdhënje detyrimore kontraktuese ku kanë arritur lidhjen e marrëveshje kreditore për kredi për biznes me nr.1385/2/Gja të datës 30.09.2010 në vlerë prej 233,000.00 euro, si dhe marrëveshje kreditore për kredi për biznes me nr.64071/1/Gja të datës 19.04.2012 në vlerë prej 200,000.00 euro, me këto marrëveshje palët kontraktuese janë pajtuar me kushtet të cilat i përmbajnë të njëjtat po ashtu edhe për kundër marrjes së kredisë të paditurit nuk iu kanë përmbajtur obligimeve të tyre. Nga pasqyra e paditësit gjegjësisht plani i amortizimit të kredisë së datës 29.03.2017, gjykata ka vërtetuar se për kredin e lejuar në shumën prej 233,000.00 euro, kryegjēja është në shumën prej 139,757.41 euro, ndërsa interesi i rregullt është në shumë prej 25,696.87 euro, andaj borxhi për kredin e parë arrin shumën prej 165,454.28 euro, kurse për kredin e dytë të lejuar në shumë prej 200,000.00 euro, kryegjēja është në shumën prej 192,699.94 euro, ndërsa interesi i rregullt është në shumë prej 58,234.30 euro, andaj borxhi për kredin e dytë arrin shumën prej 250,934.24 euro, kështu që gjykata ka ardhur në përfundim se në bazë të pasqyrës së paditësit borxhi total i të paditurve është në shumë prej 416,388.52 euro, prandaj gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 17 të LMD-së me të cilën parashihet se “pjesëmarrësit në marrëdhënjet detyrimore janë të obliguar ti përmbushin detyrimet e veta siç janë marrë vesh dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij” dhe nga kjo del se të paditurit nuk e kanë përmbushur detyrimin siç është paraparë në marrëveshje, po ashtu Gjykata u bazua edhe në nenin 1065 të LMD-së, ku parashihet se “me kontratën e kredisë banka detyrohet që shfrytëzuesit të kredisë t’i vënë në dispozicion shumën e kontraktuar të mjeteve në të holla, në kohë të caktuar apo të pacaktuar, për ndonjë destinim të caktuar ose padestinim të caktuar, ndërsa shfrytëzuesi i kredisë detyrohet që bankës t’ia paguan kamatën e kontraktuar dhe shumën e marrë të të hollave t’ia kthejë në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me kontratë”.

Edhe me nenin 1004.3 të LMD-së është përcaktuar se “dorëzanësi për detyrimin e lindur nga kontrata në ekonomi përgjigjet si dorëzanës pagues në qoftëse nuk është kontraktuar diçka tjetër”, për faktin se pala kredimarrës nuk e ka përmbushur detyrimin e vet në tërësi sipas kontratës, paditësi në pajtim me nenin 262 dhe neni 1004.3 të LMD-së, ka kërkuar përmbushjen e detyrimit dhe nga të paditurit të tjerë si debitorë solidar.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurve të dhënë në përgjigjet në padi mirëpo gjykata i refuzoi si të pabazuara për shkak se nuk kanë ofruar asnjë provë më të cilat do ti mbështesnin

pretendimet e veta ashtu siç parashihet edhe me dispozitën e nenit 319 të LPK-së, e për më tepër të paditurit nuk kanë marr pjesë as në seancat gjyqësore.

Meqenëse të paditurit, kanë rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, gjykata e detyroj të paditurën që tja paguaj paditësit, shumën e gjykuar së bashku me kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga parashtrimi i padisë, ndërsa refuzohet llogaritja e kamatës mbi kamatë për kamatëvonesën, bazuar në nenin 279 të LMD-së.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartëcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më lartë, gjykata konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar andaj edhe u aprovua si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurve, i referohen shumës së precizuar si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi, dhe atë taksën për padi shumën prej 500.00 euro.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës gjykata ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 17, 1065, 1004.3 të LMD-së, si dhe 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
III.EK.nr.521/15, me datë 22.05.2017

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.